


Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec / Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly Rahovec

Drejtoria e Urbanizmit, planifikim dhe mbrojtje e mjedisit

Uprava za urbanizam, planiranje i zashtitu okoline

Department for Urbanism, planning and environmental protection

Data: 12.03.2020

Numri i vrojtimit i lejes: 12

Spektori për urbanizëm ,planifikim dhe mbrojtje mjedisit ,duke shqyrtuar kërkesën e Drejtoris se Sherbimeve Publike pran K. Rahovec me nr.12 Nr. 350/02-0027281/19-161 të datës 17.01.2020 për projektin “Hartimi i rrugës me katër shirita Xërxë –Rahovec“ në kom. Rahovecit, Drejtoria e Urbanizmit , Planifikim dhe Mbrojtje Mjedisit k. Rahovec , për lëshimin e lejes ndërtimore për Auto rruga Rahovec -Xërxë (projekt investiv k. Rahovec; Memorandumi i mirkuptimit për financim e projekteve infrastrukturore në komunën e Rahovecit), në pronë pasuri shtetore kk Rahovec - rrugët , në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21 , Rregullores komunale mbi rregullat dhe procedurat për ndërtimin e objekteve investive me 01 nr. 109 të datës 14.07.2006 , dhe Ligjit për Procedurën Administrative, Nr. 02/L-28, neni 11, si dhe aplikacionit dhe dokumenteve të paraqitura, Drejtoria e Urbanizmit,planifikim dhe mbrojtje e mjedisit lëshon këtë :

VENDIM

(për Leje Ndërtimore)

Kjo Leje Ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	Drejtoria e Sherbimeve Publike Kom. Rahovec		
Adresa:	Rr. Deshmoret e Pashtrikut pn		
Telefoni:	--	Emaili:	

Emri iProjektit:	Rregullimi i rrugës Auto rruga Rahovec – Xërxë		
Emri i Projektuesit:	Proing& Partners sh.p.k. (Mentor Lekaj bach.ing dhe Shaban Idrizi ing.dip.inf.)		
Adresa:	Prishtinë , kodra e diellit, Major M Bushi 12/11 perendimi		
Telefoni:	-	Emaili:	

Për punët ndërtimore në vijim:		
Adresa e ndertimit : Rahovec - Xërxë		
Zona(t) Kadastrale: Rahovec, Fortesë, Xërxë	Nr. i parcelave kadastrale: rrugët	GPS Koordinatat:

Lloji i ndërtimit të propozuar:	
Ndërtim i ri ☒	Rindërtim ☐ Rrënim ☐ Riparim ☐
Kategoria e ndërtimeve të propozuara:	
Kategoria I ☐	Kategoria II ☒
Përdorimi i propozuar rruga	A përfshin kërkesa ndryshim të destinimit? Po ☐ Jo ☒
Përshkrimi: Auto rruga Rahovec - Xërxë, (titulli: Ndertimi i auto rrugës Rahovec - Xërxë)	

Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore **Drejtoria e Sherbimeve Publike** i lejohej ndërtimi i **“Hartimi i rrugës me katër shirita Xërxë –Rahovec”**

Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin;
- Të sigurojë që kontraktuesi në vendndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
 - një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - një kopje të kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë;
 - një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të “APROVUAR” nga organi kompetent;
 - projektin kryesor me të gjitha faza për nevoja të realizimit të ndërtimit;
 - dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
 - kartelën e inspektimeve të miratuara, të vendosur në vend të dukshëm dhe e ruajtur nga dëmtimi nga moti sepse është i domosdoshëm kur investuesi të aplikoj për certifikatë të përdorimit;
 - Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent mbi synimin për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
 - Të kontaktojë organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuata dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;
 - Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.

Ar sy e t i m

Aplikuesi **Drejtoria e Sherbimeve Publike** ka kërkuar nga organi kompetent **Drejtoria e Urbanizmit...** lëshimin e Lejes Ndërtimore për objektin e për ndërtimin e rrugës me katër shirita Xërxë –Rahovec, sipas projektit **“Hartimi i rrugës me katër shirita Xërxë –Rahovec”** me projektues **Proing& Partners sh.p.k.** (Mentor Lekaj bach.ing dhe Shaban Idrizi ing.dip.inf.) . Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të ndërtimor të lëndës, Memorandumi i mirkuptimit për financim e projekteve infrastrukturore në komunën e Rahovecit, si dhe bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, Ligjin Nr.02/L-28 të Procedurës Administrative dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.

Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Projekti i Autoudhes, **Rahovec - Xërxë** (projektues **Proing & Partners sh.p.k** (Hartimi i rrugës me katër shirita Xërxë –Rahovec) gushtë 2019
- Memorandumi i mirkuptimit për financim e projekteve infrastrukturore në komunën e Rahovecit
- Kërkesa

Nga një kopje të këtij vendimi t'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës,
2. Arhivit urbanizmit



Drejtori

Rumir Zhuniqi